



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR PËRCAKTIMIN E SASISË SË FONDIT PUBLIK QË DO T'U SHPËRNDAHET SI PARADHËNIE PARTIVE TË REGJISTRUARA SI SUBJEKTE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 10.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

Objekt: Përcaktimi i sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahe si paradhënie partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 qershor 2019.

Baza Ligjore: Neni 23, pika 1, gërma a, neni 87, pika 1, neni 87/2, neni 87/3 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Kodi Zgjedhor në nenin 87, pika 1, përcakton se, partitë politike pjesmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0.5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje.



Nr. 830 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit

Ora 14:00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që t'u shpërndahe si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

Gjithashtu, Kodi Zgjedhor në nenin 87/2, dhe 87/3, pika 5 përcakton se, fondi i përcaktuar me vendim të Kuvendit, sipas pikës 1 të nenit 87, u ndahet si paradhënie partive jo më vonë se 5 ditë nga rregjistrimi i partive të regjistruara si subjekte zgjedhore, si më poshtë:

- a) 95 për qind e fondit i shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, të cilat kanë përfituar jo më pak se 0.5 për qind të votave të vlefshme në zgjedhjet paraardhëse;
- b) 5 për qind e fondit i shpërndahet partive politike që janë regjistruar si subjekte zgjedhore dhe që nuk përfitojnë sipas shkronjës "a" të këtij neni.

Nen 87/3, pika 4 përcakton se fondi i përcaktuar për t'u shpërndarë, sipas nenit 87/2, i jepet secilës parti jo më vonë se 5 ditë nga rregjistrimi i listave shumemërore.

Për zgjedhjet për Organet e Qeverisje Vendore të datës 30 qershor 2019, regjistruan listat shumemërore në KQZ, 36 parti politike si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë
2. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
3. Partia Demokracia Sociale
4. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare
5. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare
6. Parti Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane
7. Partia G 99
8. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet
9. Partia Ardhmëria Shqiptare
10. Partia Demokrate Për Integrim e Prosperitet
11. Partia e Gjelbër
12. Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar
13. Partia Kristian Demokrate
14. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
15. Partia e Të Drejtave të Mohuara
16. Partia Uniteti Kombëtar
17. Partia Lëvizja Punëtoresh Shqiptare



Nr. 830 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit

Ora 14:00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

18. Partia Për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve
19. Partia Socialiste e Moderuar
20. Partia Socialpunëtore Shqiptare
21. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë
22. Partia Aleanca Kuq e Zi
23. Partia Bashkimi Liberal Demokrat
24. Partia Demokracia e Re Europiane
25. Partia Balli Kombëtar
26. Partia Ora e Shqipërisë
27. Partia Emigracionit Shqiptar
28. Partia Për Mbrojtjen e Të Drejtave Të Punëtorëve Të Shqipërisë
29. Partia Kombëtare Konservatore Albania
30. Partia Personat Me Aftësi Të Kufizuar
31. Partia Minoriteti Etnik Grek Për Të Ardhmen
32. Partia Për Liri Demokraci Dhe Etikë
33. Fryma E Re Demokratike
34. Partia Komuniste e Shqipërisë
35. Partia Aleanca e Maqedonasve Për Integrim Europian
36. Partia Bindja Demokratike

Kodi Zgjedhor në nenin 87/3, pika 3 përcakton se, për zgjedhjet e për qeverisjen vendore si kriter përdoret rezultati në shkallë vendi për këshillat vendorë, i shpallur nga KQZ-ja për zgjedhjet paraardhëse për qeverisjen vendore.

Sipas vendimit të KQZ-së nr.965, datë 10.08.2005 "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 ", partitë politike që kanë përfituar jo më pak se 0.5% të votave dhe që përfitojnë nga ndarja e 95% të shumës së akorduar nga buxheti i shtetit partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, janë si më poshtë:



Nr. 830 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit

Ora 14:00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

1. Partia Socialiste e Shqiperise	402,709	25.78%
2. Fryma e Re Demokratike	29,984	1.92%
3. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	22,320	1.43%
4. Partia Demokracia Sociale	20,064	1.28%
5. Partia Socialiste e Moderuar	15,355	0.98%
6. Partia Balli Kombëtar	14,137	0.90%
7. Partia Bashkimi Liberal Demokrat	12,949	0.83%
8. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare	12,647	0.81%
9. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	11,392	0.73%
10. Partia Ora e Shqipërisë	10,745	0.69%
11. Partia e Gjellbër	10,221	0.65%
12. Partia Uniteti Kombëtar	10,078	0.64%
13. Partia G99	9,490	0.61%
14. Partia Kristian Demokrate	9,424	0.60%
15. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	9,008	0.58%
16. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	7,953	0.51%

Përsa më sipër, 61.75 milionë lekë, 95% e fondit të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim, ndahet ndërmjet 16 partive politike të listuara më sipër. Shuma që i takon secilës parti politike gjendet duke pjestuar shumën prej 61.75 milionë lekësh me 608.476 vota të vlefshme të grumbulluara nga 16 partitë politike që përfitojnë nga 95% i shumës së akorduar nga



Nr. 830 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit

Ora 14:00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019

buxheti i shtetit, herësi që del shumëzohet me numrin e votave që ka përfituar secila parti në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

Pjesa tjetër e fondit prej 3.25 milionë lekësh, 5% e fondit të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim, ndahet ndërmjet 20 partive politike të cilat janë regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019 dhe nuk përfitojnë nga ndarja e 95% të fondit. Shuma që i takon secilës nga 20 partitë politike që përfitojnë nga 5% i shumës së akorduar nga buxheti i shtetit gjendet duke pjestuar shumën prej 3.25 milionë lekësh me 20, numri i partive që përfitojnë, 162.500 lekë është shuma që përfiton secila nga 20 partitë politike. Në total, fondi prej 65 milionë lekësh i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore, do t'u shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 87, pika 1, nenin 87/2, nenin 87/3, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të shpërndajë si paradhënie, fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare



Nr. 830 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit

Ora 14:00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019



Nr. 830 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit

Ora 14:00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019